

## Partnerët



**KOSOVË**  
Qendra për Kurajo Politike (CPC)  
[www.cpc-ks.org](http://www.cpc-ks.org)



**KROACI**  
Fakulteti i Shkencave Humane dhe Shoqërore,  
Universiteti i Zagrebit (FFZG)  
[www.ffzg.unizg.hr](http://www.ffzg.unizg.hr)



**MAQEDONI**  
Universiteti Ss. Cyril and Methodius, Instituti për Kërkim Sociologjik,  
Politik dhe Juridik (ISPJR)  
[www.isppi.ukim.edu.mk](http://www.isppi.ukim.edu.mk)



**MAL i ZI**  
Qendra për Monitorim dhe Kërkim (CeMI)  
[www.cemi.org.me](http://www.cemi.org.me)



**SERBI**  
Instituti i Shkencave Ekonomike (IES)  
[www.ien.bg.ac.rs](http://www.ien.bg.ac.rs)



**SHQIPËRI**  
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)  
[www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)



**SLLOVENI**  
Arkivi Slloven i të Dhënave i Shkencave Shoqërore (ADP) i  
Universitetit të Lubjanës (UL)  
[www.adp.fdv.uni-lj.si](http://www.adp.fdv.uni-lj.si)



**ZVICËR**  
Qendra Zvicerane e Ekspertizës në Shkencat Shoqërore (FORS)  
[www.forscenter.ch](http://www.forscenter.ch)



# seeds

South-Eastern European Data Services

## Çfarë është SEEDS?

SEEDS – Arkivi i të Dhënave në Evropën Jug-Lindore – është një projekt i mbështetur nga Fondacioni Kombëtar Zviceran i Shkencës dhe synon krijimin e arkivave të të dhënave për shkencat sociale në Kosovë, Kroaci, Mal të Zi, Maqedoni, Serbi dhe Shqipëri.

Nën drejtimin e arkivave kombëtare zvicerane dhe slovene (FORS dhe ADP), projekti do të forcojë kapacitetet e institucioneve partnere të përzgjedhura, do të kontribuojë në thellimin e njohurive si dhe në zhvillimin instrumenteve në lidhje me infrastrukturën e arkivimit të të dhënave. SEEDS do të afrojë institucionet partnere më pranë një lëvizje dhe rrjetëzimi ndërkombëtar, duke mundësuar përfitime afatgjata për institucionet partnere, por mbi të gjitha edhe për komunitetet kërkimore kombëtare duke i bërë të dhënat më të aksesueshme për analizë dytësore.

## Arkivimi dhe shpërndarja e të dhënave – pse është e rëndësishme?

Aktualisht, të dhënat parësore të mbledhura nga studimet në shkencat sociale në pjesën më të madhe të vendeve të Evropës Jugore mbeten kryesisht në zotërim të kërkuesve ose institucioneve të tyre. Këto të dhëna shpesh nuk janë të disponueshme për kërkuesit e tjerë të fushës, pavarësisht potencialit që kanë këto të dhëna në adresimin e pyetjeve të tjera kërkimore të rëndësishme.

Momentalisht, në këto shtete arkivat e të dhënave të shkencave sociale, që mund të merren me çështjet e ruajtjes dhe shpërndarjes së të dhënave parësore, nuk ekzistojnë ose nuk janë të qëndrueshme.

### Arkivimi dhe shpërndarja e të dhënave nëpërmjet një arkivi:

- Siguron ruajtjen e të dhënave kërkimore në një ambient të sigurt;
  - Inkurajon kërkimin shkencor dhe debatin;
  - Rrit impaktin dhe vizibilitetin e kërkimit;
- Promovon dhe vlerëson kërkimin që gjeneroi të dhënat;
- Zvogëlon kostot në dublikimin e mbledhjes së të dhënave;
- Ofron burime të rëndësishme për edukim dhe trajnim; dhe
  - Forcon metodologjitë e kërkimit.

## Cilat janë objektivat kryesorë të SEEDS?

1.

Vendos institutet kërkimore partnere në pozicionin e duhur për të shërbyer si arkiva të dhënash kombëtare, në shërbim të komuniteteve të kërkuesve.

2.

Ndërton dhe forcon kapacitetet arkivore, njohuritë dhe infrastrukturën teknike.

3.

Promovon shpërndarjen e të dhënave dhe analizave dytësore me vendet partnere.

4.

Përgatit shërbimet e reja arkivore në vendet e Evropës Jug-Lindore për t'u bërë anëtarë të CESSDA – Partneriteti Evropian i Arkivave të të Dhënave në Shkencat Sociale.

## AKSES I HAPUR

Aksesi i hapur (open access) i referohet parimit të reduktimit të barrierave në marrjen e të dhënave kërkimore dhe të publikimeve. Meqë kërkimi dhe inovacioni ndërtohen mbi arritjet e mëparshme, një sistem efikas për ndarjen e gjerë dhe aksesin tek të dhënat kërkimore dhe publikimet mund të përshpejtojë progresin shkencor. Në vijim të iniciativave të ndryshme në nivel evropian (p.sh. Horizon 2020), projekti SEEDS adreson nevojën për një akses dhe shpërndarje më të madhe të të dhënave parësore të mbledhura gjatë kërkimit në shkencat sociale. Ai synon të përforcojë strategjitë dhe strukturat kombëtare specifike ekzistuese, ndërkohë që kontribuon në zhvillimin e strategjive dhe strukturave të reja.